

NISMA për Kosovën

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2015 - 31 Dhjetor 2015

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se NISMA për Kosovën

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik NISMA për Kosovën (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “NISMA”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2015, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faq. 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinion të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2015, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare te bashkëngjitur, SP nuk ka bartur humbjen nga viti i kaluar ne vlerë 19,950.90 euro duke nënvlerësuar kështu burimet e financimit.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite ne kundërshtim me kërkesat ligjore te Ligjit për parandalimin e

shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, neni 25 pika 2 të Ligjit Nr.03/L-196, Detyrimet shtesë të partive politike.

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera gjatë kësaj periudhe, jo në të gjitha rastet ka aplikuar procedurat të tenderimit, ku do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2 në afatin që përcakton Ligji, por të njetat i ka publikuar në muajin Shkurt 2017.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpëlarjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Besa Berisha
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	3,609.04	4,363.49
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		3,609.04	4,363.49
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	0.00	7,872.01
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		0.00	7,872.01
Total pasuritë		3,609.04	12,235.50
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		(24,375.38)	(19,950.91)
Total Ekuiteti		(24,375.38)	(19,950.91)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	2	3,609.04	4,363.49
Gjithsej detyrimet afatgjata		3,609.04	4,363.49
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4	10,671.31	23,089.17
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	13,704.07	4,733.75
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		24,375.38	27,822.92
Gjithsej detyrimet		27,984.42	32,186.41
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		3,609.04	12,235.50

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2015	2014
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		179,800.00	96,500.00
Të hyrat nga anëtarësia			2,814.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	6	5,805.50	10,033.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	7	6,315.86	1,000.00
Të hyrat e fushatës			46,732.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5	751.79	932.66
Të hyrat tjera		1,758.90	
Gjithsej të hyrat për vitin		194,432.05	158,011.66
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	8	114,140.39	52,467.05
Shpenzimet e transportit	8	16,871.70	3,896.57
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	8	14,029.54	18,183.98
Shpenzimet e fushatës	8	0.00	67,580.00
Blerja e mallrave	8	1,185.00	5,296.14
Shpenzimet e përgjithshme	8	65,585.71	22,148.15
Shpenzimet e ndryshme	8	6,995.09	8,390.67
Gjithsej shpenzimet për vitin		218,807.43	177,962.56
Suficiti /(deficiti) për vitin		(24,375.38)	(19,950.90)

1. Informata te përgjithshme

NISMA për Kosovën është subjekt politik i certifikuar nga KQZ-ja.

Udhëheqja: Fatmir Limaj (Kryetar i partisë)
Selia : Rr “Mujo Ulqinaku” nr. 18 – qyteza Pejton
Numri fiskal : 601132757
Përfaqësuesi i autorizuar financiar : Faton Thaçi

Pasqyrat financiare të SP NISMA për Kosovën janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nën 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari të vetme bankare në bankën NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

Përshkrimi	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////////////////////		0.00
Objektet					0.00
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës	3,105.31	930.00	621.06	569.04	2,845.21
Pajisjet e teknologjisë informative	449.69	0.00	149.90	74.95	224.84
Pajisjet tjera	808.49	0.00	161.70	107.80	538.99
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	4,363.49	930.00	932.66	751.79	3,609.04

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parësë

	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro
Paraja në bankë	0.00	7,822.48
Paraja në arkë		49.53
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parësë	0.00	7,872.01

Shënimi 4. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro
Europrinty	6,501.67	13,610.62
HIB Petroll	2,761.81	1,399.68
KEDS	74.09	31.97
AGRO KOP	900.00	
Llogari të pagueshme të tjera	433.74	8046.89
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	10,671.31	23,089.16

Shënimi 5. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	1,164.01	1,164.01
Detyrimet për qira	12,540.06	3,569.74
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrimet tjera afatshkurtra		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	13,704.07	4,733.75

Shënimi 6: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Jakup Krasniqi	Prishtine		Sipas specifikacionit	1,350.00	1,350.00	
Valdete Bajrami	Gjilan		Sipas specifikacionit	1,830.00	1,830.00	
Illir Bajrami	Gjilan		Sipas specifikacionit	290.00	290.00	
Shukrije Bytyçi	Malisheve		Sipas specifikacionit	1,120.00	1,120.00	
Eshref Vishi	Ferizaj		Sipas specifikacionit	220.00	220.00	
RISICONSTRUCTIONS SARL	Ferizaj		Sipas specifikacionit	995.50	995.50	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				5,805.50	5,805.50	0.00

Shënimi 7: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Material reprezentativ	Europrinty	Rr.Rexhep Krasniqi - Kalabri	600840020	06.02.2015	6,315.86
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					6,315.86

Shënimi 8: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	95,499.70	95,499.70	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	5,594.67	5,594.67	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	5,594.69	5,594.69	0.00
Tatimet në të ardhura personale	4,951.33	4,951.33	0.00
Beneficionet tjera	2,500.00	1,793.10	706.90
Gjithsej	114,140.39	113,433.49	706.90
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	12,543.20	11,181.03	1,362.17
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	1,014.00	1,014.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	3,314.50	3,224.50	90.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	16,871.70	15,419.53	1,452.17
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	1,166.40	1,166.40	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	12,863.14	7,863.14	5,000.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	14,029.54	9,029.54	5,000.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			

Furnizimi i zyrës	1,185.00	1,185.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	1,185.00	1,185.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	55,680.77	46,710.45	8,970.32
Telefoni, interneti dhe posta	4,392.39	4,364.93	27.46
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	4,760.76	4,557.81	202.95
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	751.79		
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	65,585.71	55,633.19	9,200.73
Shpenzimet e ndryshme			
Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	2,400.00	1,500.00	900.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	4,595.09	4,595.09	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	6,995.09	6,095.09	900.00
Gjithsej shpenzimet			
	218,807.43	200,795.84	17,259.80

Shënimi 9: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Furnizimi me material shpenzues	Europrinty	Prishtine	600840020	.3.04.2015	45.61
Furnizimi me leter	Europrinty	Prishtine	600840020	23.2.2015	27.65
Shtypja e materialit reprezentativ	Europrinty	Prishtine	600840020	06.02.2015	6,315.86
Furnizimi me material shpenzues	Europrinty	Prishtine	600840020	27.07.2015	155.00
Furnizimi me material shpenzues	Europrinty	Prishtine	600840020	27.07.2015	100.00
Shpenzimet e materialit per	Europrinty	Prishtine	600840020	12.01.2015	91.58
Shtypja e librezave	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	780.00
Leter pploteri CITY LIGHT	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	140.00
Punimi I vulave	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	404.28
AH>EP. Shtyp plluteri	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	94.50
Punimi I vulave	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	40.89
Printim A4	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	21.00
Printim A4	Europrinty	Prishtine	600840020	20.02.2015	21.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					8,237.37